



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:115536

Datë: 12.07.2022

Numri i dokumentit: 03218276

P.nr.100/2018

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Atdhetare Bashota Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurve: M.H., për shkak të veprës penale: Vjedhje nga neni 325, par. 1 e lidhur me nenin 31, të Kodit nr. 04/L082 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.417/2018, të datës 15.02.2018, jashtë seancës, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, e në mbështetje të nenit 358 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPP), më datë 12.07.2022, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

1. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.417/2018, të datës 15.02.2018, dhe, PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurve:
  - M.H., nga i ati I., e ëma H., e vajzërisë H., “data e lindjes”..., në komuna e Gllogovcit, tanoi jeton në Prishtinë, shqiptar, shtetas i Kosovës,
  - A.H., nga i ati S., e ëma S., e vajzërisë G., “data e lindjes”..., në komuna e Vushtrrisë, ku edhe tani jeton, me nr. personal..., i martuar, shqiptar, shtetas i Kosovës,për veprën penale: Vjedhje nga neni 325, par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.
2. Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.
3. Lidhur me kërkesën pasurore-juridike, pala e dëmtuar, E.G., udhëzohet në kontest të rregullt civil.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.417/2018, të datës 15.02.2018, kundër të pandehurve: M.H. dhe A.H., për shkak të veprës penale: Vjedhje nga neni 325, par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjyqtari, lëndën në fjalë e ka pranuar më datë 12.05.2022 dhe pasi ka marr veprimet e nevojshme në këtë çështje penale, konstatoi se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për të pandehurit M.H. dhe A.H., për veprën penale: Vjedhje nga neni 325, par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës, të akuzuarit janë akuzuar nën dyshimin për veprën penale: Vjedhje nga neni 325, par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën veprën penale sipas ligjit është përcaktuar dënimi me burgim deri në tre (3) vjet.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se të akuzuarit, veprën penale dyshohet ta kenë kryer më datë 16.04.2016 dhe që nga ajo kohë, koha e kryerjes, e deri me tani kanë kaluar me tepër se gjashtë (6) vjet.

Në nenin 106, par.1, nënpar. 1.5, të KPRK-së është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre (3) vjet nga koha e kryerja së veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim e deri në tre (3) vjet. Ndërsa, neni 107 par. 8 përcakton se, ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Rrjedhimisht, gjykata konstaton se nga kryerja e veprës penale e deri më tani ka kaluar më shumë se dyfishi i kohës që kërkohet për arritjen e parashkrimit, çka do të thotë se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në bazë të nenit 107 par. 8 i KPRK-së, sepse brenda kësaj periudhe kohore nuk ka përfunduar ndjekja penale. Saktësisht, parashkrimi absolut i ndjekjes penale në këtë rast penal ka arritur më datë 16.04.2022.

Gjykata, konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurve, ka arrit parashkrimi absolut i ndjekjes penale, për këto vepra penale që janë akuzuar, si në dispozitiv të këtij aktvendimi, kjo Gjykatë ka marr aktvendim, e ka hedhur akuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tyre.

Aktvendimi mbi parashkrimin absolut është bazuar në kuptim të nenit 106 par.1 nënpar.5 dhe nenit 107 par.8 të KPRK-së, si dhe neni 358 të KPP-së, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 454 par 1 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.100/2018, datë 12.07.2022**  
**2019:115536, 12.07.2022**

**Gjyqtari**

**Rrahman H. BEQIRI**

**KËSHILLA JURIDIKE;** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar ne afatin prej 3 ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.